

URDHËR

Nr. 18, Datë 11/05/2015

**MBI PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR ÇAKTIMIN E FITUESIT NË
PROKURIMET E ZHVILLUARA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 55 (*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*) të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, **pika 8**, të nenit nr.66 (*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*), të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 39 të Statutit Akademisë së Arteve,


URDHËROJ

1. "Autoriteti Kontraktor", i Universitetit të Arteve, i përfaqësuar nga Rektori i UART, urdhëron organizimin e shortit midis operatorëve ekonomik për rastet e parashikuara nga **pika 8**, të nenit nr.66 (*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*), të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
2. Procedurat e shortit organizohen jo më herët se 3 ditë nga urdhëri për shortin. Data, ambjete dhe ora e zhvillimit të shortit shpallen në faqen zyrtare të UART (*rubrika e transparencës*) dhe operatorët ekonomik njoftohen edhe shkresërisht;
3. Hedhja e shortit organizohet nga KVO dhe NJP në seancë publike;
4. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, Kryetari i KVO sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të operatorëve ekonomik dhe i fton të zënë vendet e caktuara;
5. Në një kuti/enë/ transparente futen aq gogla sa është numëri i operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në short;
6. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letër **ku në njërin prej tyre** shënohet fjala "**FITUES**";
7. Radha e tërheqjes së goglave, sipas pikës 6, këtij urdhëri, përcaktohet **me parashort**, i cili zhvillohet sipas kësaj procedure:



- a) Në një kuti/enë/ tjetër transparente futen aq gogla sa është edhe numri i operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në short. Në çdo gogël futet një shirit letre në të cilin është shënuar emri i operatorit ekonomik pjesëmarrës në short;
 - b) KVO cakton një anëtar nga NJP, i cili tërheq goglat. Operatori ekonomik, emri i të cilit është shënuar në goglën **që tërhiqet e para**, do të jetë i pari në radhën e tërheqjes së shortit, sipas pikës 6, të këtij urdhëri. Në këtë mënyrë procedohet deri në tërheqjen e goglës së fundit;
 - c) Kryetrari i KVO, fton me radhë përfaqësuesit e operatorëve ekonomik për tërheqjen e shortit;
 - d) **Mosparaqitja** e ndonjë prej përfaqësuesve të operatorëve ekonomik midis të cilëve hidhet shorti, nuk pezullon procedurën e shortit. Në këtë rast procedura për tërheqjen e shortit për operatorin ekonomik në mungesë, bëhet nga një person i caktuar me urdhër të Rektorit të UAR;
8. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik, pasi e hap goglën, ia dorëzon shiritin e letrës që gjendet brenda saj, Kryetarit të KVO, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë përfaqësuesëve të operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në short;
 9. Pasi është tërhequr gogla me shënimin "**FITUES**", Kryetari i KVO hap me radhë goglat e mbetura në kuti/enë nëse ka dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësëve në këtë mbledhje të përbashkët të KVO, NJP, përfaqësuesëve të operatorëve ekonomik, dhe personave të tjerë;
 10. Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KVO merr vendim për shpalljen e rezultatit të shortit;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË